FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 157

Tiranë – E hënë, 30 tetor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 296, datë 24.10.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	16903
Dekret i Presidentit nr. 297, datë 24.10.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	16903
Dekret i Presidentit nr. 298, datë 24.10.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	16903
Dekret i Presidentit nr. 299, datë 24.10.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	16903
Dekret i Presidentit nr. 300, datë 24.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16904
Dekret i Presidentit nr. 301, datë 24.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16904
Dekret i Presidentit nr. 302, datë 24.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16904
Dekret i Presidentit nr. 309, datë 26.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16905
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 161, datë 26.10.2023	Për delegim kompetence.....	16905
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 617, datë 26.10.2023	Për delegim kompetence.....	16905
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 16062, datë 26.10.2023	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshje dypalëshe me Republikën Federale të Gjermanisë.....	16906

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 293, datë 12.10.2023	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria "Albgaz" sh.a.....	16906
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 294, datë 12.10.2023	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin shtator 2023, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	16907
	Korrigjim gabimi material në kërkesën e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, me nr. 362/14 prot., datë 27.9.2023, "Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga projekti 'Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore', të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 140, datë 27.9.2023.....	16909

DEKRET
Nr. 296, datë 24.10.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Resald Agim Sino
2. Alesia Robert Xhuxha (Beluli)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 297, datë 24.10.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Malvina Asllan Thaçi (Mulaj)
2. Floresha Dilaver Begollari (Memeti)
3. Manjola Sami Metani
4. Hane Idriz Salja
5. Elvis Fotaq Papa
6. Blerina Sadedin Heimbürger (Çeliku)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 298, datë 24.10.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Denis Petrit Pushaj
2. Marsia Erion Duraj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 299, datë 24.10.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Oresti Genci Sade
2. Drilona Isak Cenaj (Bajra)
3. Erjon Ramadan Muja
4. Valbona Ylber Thomallari (Braha)
5. Eglantina Haziz Bunk (Selba)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 300, datë 24.10.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20, e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Anila Bardhosh Godeni
2. Shkelzen Masar Meqa
3. Vezir Rufat Kolukaj
4. Blerton Ramiz Kuksi
5. Afërdita Hysen Shehu (Beqa)
6. Baton Selajdin Boshnjaku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 301, datë 24.10.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20, e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Drenushë Bujar Bedra Uka
2. Arlind Elez Sezallari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 302, datë 24.10.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20, e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Nurije Deli Mariqi (Guci)
2. Edibe Zulfi Rudaj (Koçinaj)
3. Amir Mexhit Shehu
4. Taulant Shukri Gutaj

5. Gjylymsere Emin Biri (Kadriaj)
6. Azem Ismet Hoxhaj
7. Albi Florent Meqa
8. Ramadan Ismail Hoti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 309, datë 26.10.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, nenit 20, e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Vesa Ismet Paçarizi
2. Fortesa Sabit Berisha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 161, datë 26.10.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të nenit 14, të ligjit nr. 128/2021, "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, z. Dritan Dorda.
2. Kompetencat e deleguara të ushtrohen deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, z. Dritan Dorda.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

URDHËR
Nr. 617, datë 26.10.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, për datën 27.10.2023, zëvendësministrit të Drejtësisë, znj. Adea Pirdeni.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Adea Pirdeni, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

NJOFTIM
Nr. 16062, datë 26.10.2023

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJE DYPALËSHE ME REPUBLIKËN FEDERALE TË GJERMANISË

"Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunimin Teknik 2022 për Projektin "Ekonomia qarkulluese për zhvillimin e qëndrueshëm urban në Shqipëri"", nënshkruar më 17.7.2023, ka hyrë në fuqi më datë 18.10.2023.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Turdiu

VENDIM
Nr. 293, datë 12.10.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E PLANIT DHJETËVJEÇAR TË INVESTIMEVE NGA SHOQËRIA "ALBGAZ" SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 16, pika 12, 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; neneve 8, 9, 10 të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 18, datë 10.01.2018; si dhe neneve 15 dhe 19 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2152/4 prot., datë 10.10.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së planit të dhjetëvjeçar të investimeve për periudhën 2023–2032 të shoqërisë 'Albgaz' sh.a.",

konstatoi se:

- Shoqëria "Albgaz" sh.a., në cilësinë e operatorit të kombinuar të gazit natyror, nëpërmjet shkresës me nr. 103 prot., datë 12.9.2023, protokolluar me tonën me nr. 2152 prot., datë 12.9.2023, paraqiti kërkesën për miratimin e planit të investimeve dhjetëvjeçar, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për gazin natyror në Republikën e Shqipërisë, që përmban investimet afatshkurtra e afatmesme të kompanisë.

- Aplikimi për miratimin e planit të investimeve dhjetëvjeçar nga ERE është bërë në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenet 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 8, pikës 1, të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror", miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s nr. 18, datë 10.01.2018.

- Shoqëria "Albgaz" sh.a. deklaron se parimet e ndjekura në hartimin e planeve të investimeve janë në harmoni me strategjinë kombëtare të zhvillimit të sektorit të gazit natyror, të miratuara me VKM-në nr. 87/2018, "Për miratimin e planit kombëtar për sektorin e gazit (masterplanit të Sektorit të Gazit për Shqipërinë, e ndryshuar me VKM-në nr. 563, datë 4.10.2023, të parashikuara në nenin 6, germat "a" dhe "b", të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror".

- Në zbatim të nenit 8, pikës 6, germa "d", të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror", shoqëria duhet të paraqesë një analizë të plotë të përfitimit të kostos, që vërteton efektivitetin e çdo projekti të planifikuar dhe justifikon kostot që lidhen me to.

- Në zbatim të nenit 6, germa "f", të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror", shoqëria "Albgaz" sh.a. ka detyrimin e publikimit të planit të investimit në faqen e saj zyrtare. Në kuadër të aplikimit në ERE shoqëria "Albgaz" sh.a. ka bërë me dije, se në përputhje me nenin 10, pika 1, të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 18, datë 10.1.2018, është bërë konsultimi për marrjen e opinioneve nga palët e interesit, njoftime të cilat gjenden të publikuara në faqen e MIE-s, KKT-së dhe QBZ-së.

- Shoqëria "Albgaz" sh.a., aplikimin për miratimin e planit të investimeve e ka shoqëruar me dokumentacionin dhe disa raporte, studime fizibiliteti, marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet disa operatorëve dhe Ministrisë së Infrastrukturës (MIE), duke përfshirë ndër të tjera, si vijon:

- Shkresën nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 6429/1, datë 21.8.2023, nëpërmjet së cilës shprehet gatishmëria dhe mbështetja e MIE-s në realizimin e këtij projekti gjatë vitit 2023.

- Shkresën nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a. nr. 3933/4 prot., datë 11.9.2023, nëpërmjet së cilës ka kërkuar nga shoqëria "Albgaz" sh.a., që për kapacitet e instaluara të TEC Vlora, për një regjim maksimal në 80%, sasia vjetore e nevojshme e gazit do të jetë në rreth 130 mcm në vit.

- Shoqëria "Albgaz" sh.a. duhet të depozitojë në ERE opinionin nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në lidhje me planin e investimeve në zbatim të nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror"; një tabelë përmbledhëse, ku evidentohen investimet e planit dhjetëvjeçar me zërat dhe vlerat përkatëse bashkë me periudhën, kur do të kryhen investimet, duke cilësuar dhe burimin e financimit, si dhe çdo informacion apo dokumentacion tjetër të nevojshëm për të cilin mund të lindë nevoja gjatë procesit të shqyrtimit të planit të investimeve bazuar në legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e "Planit të investimeve dhjetëvjeçar nga shoqëria 'Albgaz' sh.a.".

2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 294, datë 12.10.2023

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN SHTATOR 2023, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.10.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2248/1 prot., datë 10.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i

Mundësisë së Fundit, për muajin shtator 2023, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV",

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 6806 prot., datë 4.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2248 prot., datë 6.10.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin shtator 2023, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Në lidhje me përfshirjen e kostove të disbalancave, ERE, me shkresën nr. 2000/6 prot., datë 3.10.2023, në përgjigje të shkresës së ardhur nga FSHU sh.a. me nr. 5622/2 prot., datë 7.9.2023, i kërkoi shoqërisë të evidentojë arsyet mbi pamundësinë teknike dhe problematikat që FSHU sh.a. ka hasur për modifikimin e faturës së energjisë elektrike për evidentimin e kostove të disbalancave, si dhe veprimet dhe masat e ndërmarra nga FSHU sh.a. për informimin e klientëve të cilët shërbehen në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit, për përfshirjen në faturën e konsumit të energjisë elektrike edhe të kostove të disbalancave.

- Mbështetur në nenin 8, të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin shtator 2023, janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, të Bordit të ERE-s, kostot administrative të përllogaritura për aktivitetin e furnizimit vijojnë të mbeten në vlerën 1.06 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kwh.

- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shator 2023, përllogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientòt e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin gusht 2023			
		Njësia	**Çmimi**
CBEt	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	12.23
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.37
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		**Leke/kWh**	**16.06**

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 16.06 lekë/kwh, për muajin shtator 2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin shator 2023, prej 16.06 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në kërkesën e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, me nr. 362/14 prot., datë 27.9.2023, "Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private të cilat preken nga projekti 'Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore', të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 140, datë 27.9.2023, bëhet korrigjimi në seksionin "Shënime D+E" të tabelës bashkëlidhur.

Tabela ishte:

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I INSTITUTIT TË POLICISË SHKENCORE", DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE						"NDËRTESË"			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (D+E) (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	Ndërtesë (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera sipas situacionit (lekë)		
1	AGIM VJOSA KUJTIM	ISMAIL RIDVAN MYNIR	CANI SKENDO KRYEZIU	TIRANË	8240	3/168-ND	NDËRTESË	68.53	68.53	68.53	65,000	4454450.00	4,454,450.00	shteti është pronari i truallit 3/127 të cilin ndodhet ndërtesa 3/168 diferenca dokument fakt është 15 m². kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e marrëdhënies me truallin
2	AGIM VJOSA KUJTIM	ISMAIL RIDVAN MYNIR	CANI SKENDO KRYEZIU	TIRANË	8240	3/170-N1	NJËSI	176	176	176	vlerësim sipas ekspertit	1,823,976.40	1,823,976.40	shteti është pronari i truallit 3/127 mbi të cilin ndodhet ndërtesa 3/170-n1 kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e marrëdhënies me truallin
	SHUMA PARAPRAKE												6,278,426.40	

Tabela bëhet:

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I INSTITUTIT TË POLICISË SHKENCORE", DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE						"NDËRTESË"			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (D+E) (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	Ndërtesë (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera sipas situacionit (lekë)		
1	AGIM VJOSA KUJTIM	ISMAIL RIDVAN MYNIR	CANI SKENDO KRYEZIU	TIRANË	8240	3/168-ND	NDERTESË	68.53	68.53	68.53	65,000	4454450.00	4,454,450.00	Shteti është pronari i truallit 3/127 V.2 F.173, mbi të cilin ndodhet ndërtesa 3/168. Diferenca dokument- fakt është 15 m². Kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e marrëdhënies me truallin
2	AGIM VJOSA KUJTIM	ISMAIL RIDVAN MYNIR	CANI SKENDO KRYEZIU	TIRANË	8240	3/170-N1	NJËSI	176	176	176	vlerësim sipas ekspertit	1,823,976.40	1,823,976.40	Shteti është pronari i truallit 3/127, mbi të cilin ndodhet ndërtesa 3/170-N2. Kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e marrëdhënies me truallin
	SHUMA PARAPRAKE												6,278,426.40	

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 157
Datë: 2023/10/30 15:23:40
08a4568a-3f6c-4778-b98d-3a7daa5d676c

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë